REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI

24.19

Maliq,më 20 4. 2026

PROJEKT –VENDIM -Nr. 7

Për

" Ndryshime në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2026"

Në mbeshtetje të ligjit 139/2015 date 17.12.2015"Për vetqeverisjen vendore " neni 54 "detyrat dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak, germa dh , ligjit 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 " përgatitja dhe miratimi i Buxheteve vendore " ,të ligjit Nr 68/2018 "Per financat e vetëqeverisjes vendore" Udhezimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr 2 Datë 14.01.2026, zbatimin e buxhetit të vitit 2026 » në vendimin nr 3 dt 08.01.2026 të Këshillit Bashkiak "Rishqyrtim i Vendimit të Këshillitt të Bashkisë Maliq Nr.148,datë 24.12.2025 për «Miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2026 , i propozoj këshillit të bashkisë :

1-Të miratojë ndryshime në buxhetin e vitit 2026 si më poshtë :

Pakësim

Gr	Kap	Kod prog	llog ek	kodi	Objekti	vlera në lekë
00	01	04240	6025600	9999999	Shërbim mirembajtje mjetesh	550,000
00	05	08220	6029099	9999999	Shp. të tjera , te rinjte	50,000

Shtesa

Gr	Kap	Kod prog	llog ek	kodi	Objekti	vlera në lekë
00	01	04240	2315140		Blerje kove dhe zinxhira per eskavatorin Neë Hollande E-70BSR	550,000
00	05	08220	6060099		Konkurs rinor per celjen e sezonit turistik	50,000

2.Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë mbas miratimit.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

2419

20.04.2026

RELACION

" Ndryshime në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2026"

Sipas udhëzimit Nr.30 ,datë 27.12.2011" Për menaxhimin e aktiveve në Njesitë e Sektorit Publik" meqënësë këto artikuj kanë një kosto të konsiderueshme duke tejkaluar pragun,,rritin jetën e eskavatorit ,përmirësojnë kapacitetin e tij ,janë pjesë e qëndrueshme dhe do të përdoren më shumë se një vit ,propozojmë kalimin e fondit nga shpenzime operative në shpenzime kapitale .

Në kuadër të promovimit të turizmit lokal dhe nxitjes së pjesmarrjes aktive të të rinjëve në jetën kulturore dhe artistike të qytetit,Drejtoria e Kulturës propozon organizimin e një konkursi rinor me tematikë promovimin e destinacioneve turistike të zonës.Për motivimin dhe vlerësimin e pjesmarrësve propozohet akordimi i tre cmimeve.

Ky konkurs synon të angazhojë te rinjtë në krijimin e materialeve promovuese në formë videoje,duke evidentuar vlerat natyrore,kulturore dhe artistike të territorit të Bashkisë.

Pjesmarrësit do të paraqesin nga një video-propozim për një prej destinacioneve turistike të përcaktuara.Materialet e realizuara do të publikohen në rrjetet sociale zyrtare të Qendrës kulturore "Dhimitër Orgocka"

Organizimi i këtij konkursi do të ndikojë në promovimin e turizmit lokal,rritjen e vizibilitetit të destinacioneve turistike dhe fuqizimin e rolit të të rinjve në zhvillimin kulturor të komunitetit.

Konceptoi:

Almira Muka

Genci Floqi

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al